

Mbledhja e kryesisë së shoqatës 17shkurti.ch

PROTOKOLL

DATA: 26.03.2017

KOHA: 10:30

VENDI: GLATTBRUGG

THIRRUR NGA:	Kryetari Muhamet Guda
NUMRI I MBLEDHJËS	2
UDHËHEQËS I MBLEDHJËS	Muhamet Guda
PROTOKOLLIN E SHKRUAN	Visar Kryeziu
PJESËMARRËS	Avni Kastrati, Muhamet Guda, Agron Zahiri, Visar Kryeziu
MUNGOJNË	Faik Mahmuti (eshte ne pushime)

TEMAT E DITËS

1. Shqyrtimi i detyrave qe kemi marre nga mbledhja e kaluar
2. Shpallja e konkursit per mirembajtes te fshatit
3. Projekti „Ambienti“
4. Te ndryshme

DISKUTIMI	Tema Nr. 1 Shqyrtimi i detyrave qe kemi marre nga mbledhja e kaluar	
<p>Kjo pike eshte pare si e rendesishme qe te diskutohet ne çdo fillim te mbledhjes ne menyre qe most e lihet asnje pune anash qe kemi biseduar ne mbledhjet e kaluara.</p> <p>Te gjithë anetaret e kryesise morren fjalen per detyrat qe i kishin pasur nga mbledhja e kaluar dhe skjaruan se deri ku kane shkuar punet.</p> <p>Per sponsorin general Agroni tregoi se ia ka derguar faturen qe edhe ishte detyre e tij.</p> <p>Visari tha se per punen e marketingut te sponsorit general ne webfaqe ka biseduar me sponsorin general gjegjesisht Taulant Faniqin ku ka kerkuar nga ai qe te shfrytezoj marketingun per kompanine e tij ne webfaqe te shoqates si dhe ne facebook, dhe se per çdo ndihme qe ka nevoj te drejtohet tek ai (Visari) ne lidhje me shkrimet ne faqe.</p> <p>Per Lumin "Vada" Avnia mori fjalen dhe tha se ka biseduar me disa ne fshat per kete teme dhe nuk eshte kjo bash pune e lehte te realizohet.</p> <p>Agroni tha se ne muajin Prill jemi disa nga kryesia ne pushim ne Kosove dhe eshte mire qe ne kete kohe te mbahet nje mbledhje me fshataret dhe te diskutohet kjo teme ne menyre te hapur me ta!</p> <p>Visari thote se duhet te bisedohet me ata persona qe jane me te angazhuar per fshatin.</p> <p>Agroni propozoi qe te behet nje mbledhje me fshataret me 24 prill ora 19:00 tek shtepia e kultures, dhe te gjithë ishin te pajtimit qe kjo te ndodhe. Ne kete mbledhje Muhamedi dhe Agroni priten te jene present.</p> <p>Lokali per t` pame ishte tema tjetër ku Avnia tha se ka biseduar per kete me disa persona dhe se ata kane thene qe eshte problem te funksionoj kjo pasiqe fshati eshte i gjate dhe nuk mund ta shfrytezojne kete. Por ata mendojne qe te behet nje zgjidhje per kete me shator (mbulese) ku do te ipej ne sherbim te fshatareve dhe per kete te vendoset nje pergjegjes.</p> <p>Problemi eshte menagjimi i saj dhe mirembajtja e shatorit.</p> <p>Muhamedi thote se eshte problem per kete sepse ne raste te tilla organizimet mbahen „veqë“ grate dhe „veqë“ burrat dhe se problem eshte funksionimi i mire i saj.</p> <p>Propozohet qe te xhamia posht edhe te shtepia kultures te investohet me nje inventar per raste te tilla (tpame) mirepo per kete te shkruhet nje shkrim ne webfaqe dhe te kerkohet nje mendim nga fshataret.</p> <p>Bisedohet gjithashtu si propozim qe te ndertohet nje objekt per raste te tilla ne hymje te fshatit nga Gjilani ne anen e majt, mirepo nuk eshte marr ndonje vendim per kete.</p> <p>Per uebfaqen e shoqates u bisedua dhe Agroni tregoi qe u taku me Imranin dhe se tash Agroni vet mund ti kryej te gjitha hyrje daljet ne uebfaqe te shoqates.</p> <p>Visari tha se per uebfaqen Imranit ia ka derguar te gjitha detajet te ilustruara me fotografi se çka te hjeket dhe te shtohet ne uebfaqe dhe se Imrani ka thene se do ta rregulloj kete.</p> <p>Sponzoret qe te dalin ne uebfaqe u bisedua gjithashtu dhe se Agroni tha qe do te merret me kete pune me Imranin per publikimin e tyre.</p>		
VENDIMI		
<p>Te mbahet nje takim/mbledhje me fshataret per qeshtjen e lumit (vadës) me 24 Prill ne ora 19:00 te shtepia kultures ne Miresh.</p> <p>Te shkruhet nje shkrim dhe publikohet ne uebfaqe dhe facebook ku kerkohet nga fshataret mendim per „lokalin per t` pame“ se cila eshte zgjidhja me e mire!</p> <p>Imrani ta rregulloj sipas foto-ilustrimeve uebfaqen e shoqates.</p> <p>Sponzoret te dalin ne webfaqe.</p>		
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
<p>Muhamed Guda dhe Agroni te organizojne nje mbledhje me fshataret me 24 prill.</p> <p>Visari te shkruaj shkrim per „lokalin per t` pame“</p> <p>Imrani si administrator i uebfaqes ta permiresoj/rregulloj uebfaqen</p> <p>Agroni ja bon gati sponzoret per mi publikue ne uebfaqe!</p>	<p>Agroni, Visari, Imrani</p>	<p>24 prill 2017</p>

DISKUTIMI	Tema Nr. 2 Shpallja e konkursit per mirembajtes te fshatit	
<p>Muhameti pyet kryesine se cka te bejme me tutje per punetor dhe se shumica nga pyetsori qe eshte bere ne facebook, fshataret kane dhene mendimin qe mos te kete firme por puntor per mirembajtjen e fshatit.</p> <p>Pas nje bisedimi dhe dhenje mendimesh u vendos qe te shpallet konkurs per mirembajtes te fshatit dhe te jete i hapur deri me 16 prill, ku detyrat e tij te jene mirembajtja e lumit, varrezat, parku i vogel, oborri i ambulantes dhe shtepise se kultures dhe ujitja e drujve (sipas nevojës).</p>		
VENDIMI	Te shpallet konkurs per mirembajtes te fshatit.	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Visari te shkruaj shpalljen e konkursit dhe ta publikoj ne uebfaqe dhe facebook!	Visari	Pas mbledhjes

DISKUTIMI	Tema Nr. 3 Projekti „Ambienti“	
<p>Visari tregoi se ka biseduar me nje ambientalist nga Gjilani i cili ka mundesi te medha te na ndihmoj ndonje projekt tonin qe do ta bejme per ambient. Kete projekt eshte shume e mundshme qe ta perkrah ministria e mjedisit dhe planifikimit hapsinor dhe se me 5 Qershor te shenohet dita nderkombetare e ambientit pikerisht ne Mireshe ku do te jene te pranishem shume zyrtar dhe media nga Kosova.</p> <p>Agroni tha se ne duhet ta shfrytezojme kete mundesi.</p> <p>Muhameti tha se ne ndoshta mundemi si projekt ta bejme lumin "Vada".</p> <p>Avnia tha qe ndoshta mundemi ta bejme nje projekt per ujitjen e bimeve dhe luleve qe jane te mbjelluna nga shoqata dhe fshataret.</p> <p>Si propozim ishte qe te rregullohet kanalizimi pergjat lumit ne fshat, mirepo ishte ne pikepyetje se sa kane mundesi ta mbeshtes kete ministria sepse projekti eshte mjaft i kushtueshem.</p> <p>Visari ka mbetur te bisedoj edhe nehere me personin qe na ka propozuar kete ide dhe se ta njoftoj kryesine per hapat e metutjeshme. Gjithashtu Visari ka mbetur te takohet personalisht me kete sa te jete ne pushim ne Kosove ne muajin Prill.</p>		
VENDIMI	Visari te takohet me personin qe ka propozuar qe fshati jone te perfitoj nje projekt per ambientin.	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Visari te takohet ne muajin Prill.	Visari	Muaji Prill

DISKUTIMI	Tema Nr. 4 Te ndryshme	
<p>Avnia tregon qe nje Agim Berisha person ia ka dhuru disa veshmbathje reflektuese dhe keto do te perdoren per punetoret. Agroni thote qe mulliri i fshatit eshte shume shume me vlera per Mireshe dhe se duhet te bisedojme me pronarin e tij qe nese duhet te ndihmojme diçka.</p> <p>Agroni dhe Muhameti kur te jene ne Kosove ne pushim te bisedoj me pronarin se cka ka nevoj dhe shikojne mundesine nese shoqata & komuna mund te kontribojne diçka per kete.</p> <p>Avnia tregoi se disa ulese ne park jane te demtuara dhe se duhet te riparohen dhe per kete ka material (drrasa) qe ka mbetur nga hera e kaluar. Per kete u bisedua me Bujar Hazirin qe nese ka mudnesi ai me € 50.- ta kryej kete pune.</p>		
VENDIMI	Agroni dhe Muhameti te bisedojne me pronarin e Mullirit. Te rregullohen uleset nese kushtojne € 50.-	
DETYRAT	PERSONI PËRGJEGJËS	TERMINI
Agroni dhe Muhameti te biseojne me pronarin per Mullirin. Avnia te kontaktoj me Bujarin	Muhameti, Agroni, Avnia	Muaji Prill